



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr/Br.

Datë/Datum.

105/20
11.03.2020

PRISHTINE - PRISTINA



PSH .nr.105/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: N.T.P “LULISHTJA BUQAJ”- Graçanicë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, me titull: “Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjve dekorativ-LOT 1”, me nr. të prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Rahovec, më datën: 03.03.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.T.P “LULISHTJA BUQAJ”- Graçanicë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjve dekorativ-LOT 1”, me nr. të prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Rahovec.

II. **ANULOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjve dekorativ-LOT 1”, me nr. të prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Rahovec, dhe lënda kthehet në rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: N.T.P “LULISHTJA BUQAJ”- Graçanicë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.T.P “LULISHTJA BUQAJ”- Graçanicë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP për LOT 1, me 14.02.2020 me nr 105/2020, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit me titull: “Krijimi i hapësirave gjelbëruese dhe mbjellja e drunjve dekorativ-LOT 1”, me nr. të prokurimit: 623-19-6024-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Kuvendi Komunal Rahovec, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe Vendimi i Panelit Shqyrtues PSH.nr. 683/19 të datës 19.11.2020, Urdhëresa nga PSH nr. 949/19 të datës: 30.01.2020.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.02.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 20.02.2020, Eksperti shqyrtues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 dhe 59 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se marr për bazë që ky aktivitet i prokurimit është përsëritur disa herë, lidhur me pretendimin se autoriteti kontraktues ka shkelur neni 7 dhe 59 të LPP-së d.m.th. këto pretendime

ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë të njëjta, për rastet të cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje të gjykuara “resjudikata”.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit (në këtë aktivitet të prokurimit), AK - komisioni i ri-vlerësimit për të tretën herë nuk ka ri-vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar drejt ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, me fjale tjera nuk e ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik” si dhe neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, dhe nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së me Nr. 683/19, të datës 19.11.2019, dhe Urdhëresa me Nr. 949/19, të datës 31.01.2020, si dhe duke mos ka vepruar në tërësi në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Gjithashtu, Eksperti Shqyrtues sqaron si në vijim: Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të AK-së, respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të tenderuesve, të trajtoj dhe analizoje tenderët, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterit të shpërblyerit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1 në dosjen e tenderit.

Mendimi i ekspertit profesional Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, **të aprovohet e bazuar** dhe rekomandon të anulohet B58 - njoftimi mbi vendimin AK (anulimin e aktivitetit të prokurimit) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës 20.02.2020 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me raportin e ekspertit profesional.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës 21.02.2020 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertit profesional.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 03.03.2020, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesit e AK-së si dhe Eksperti profesional, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi

mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Buçaj deklaroj: Ne pajtohemi me mendimin e Eksperti Shqyrtues dhe mbetemi në tërësi prapa ankesës sonë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së ankues z. Mullabazi deklaroj: AK ka respektuar plotësisht Urdhëresën e OSHP-së, pasi neni 2 i kësaj Urdhëresë thotë “Obligohet Autoriteti Kontraktues KK-Rahovec që ta zbatojë vendimin e OSHP 683/19, ndërsa Vendimi OSHP-së 683/19 neni 2 i këtij vendimi thotë anulohet njoftimi për kontratë dhe lënda të kthehet në rivlerësim” NE si Autoriteti Kontraktues me datë 31.01.2020 e kemi njoftuar OSHP-në se është formuar komisioni për rivlerësim dhe ky komision ka bërë ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e ofertave sipas LPP-së. Komisioni rivlerësues e ka rekomanduar menaxherin e Prokurimit që AP në fjalë të anulohet pasi që asnjë ofertues nuk është i përgjegjshëm. Tek letra standarde dërguar OE ankues Lulishtja Buçaj me datë 06.02.2020 Autoriteti Kontraktues i ka cekur arsyeje se pse tenderi juaj është refuzuar e janë shumë arsye: NE DT është kërkuar një Agronom i Diplomuar OE ankues ka dorëzuar Bachelor të Agro Ekonomisë i cili nuk është në përputhje me DT, është kërkuar përvoja e punës minimum 3 vite pas diplomimit ku CV e dorëzuar nuk ka asnjë përvojë pune vetëm ka disa Certifikata diplomën e fakultetit, tek referenca dhe Diploma është i bashkangjitur një dokument me të cilin nuk vërtetohet se kopja e noterizuar është për dokumentin në fjalë. Tek referencat e dorëzuara OE ka dorëzuar Referenca në vlerë prej 264.853.82 euro kurse në DT janë kërkuar në vlerë 370.000.00, OE ka dorëzuar referenca me kompaninë Las Palmas i cili është në konsorcium me Fidanishtja Gjellbërimi, dhe referenca tjera private nuk ka dorëzuar faturat flete dërgesat dhe transferet bankare, Ku neni 61 par 2.1 thotë kur furnizimi është bërë në një blerës privat për këtë shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i liferimit të tillë.

Tek Lista e pajisjeve mjeteve të punës është kërkuar një Eskavator ku OE nuk e ka të noterizuar DUD-in doganor sipas kërkesave në DT dhe pajisja është kërkuar me tonazh 1.5 Ton ndërsa OE e ka dorëzuar 2.5 ton, për pajisje tjera 2 Kamion, noterizimi nuk cek se dokumenti në fjalë është i vërtetuar.

Autoriteti Kontraktues e ka respektuar plotësisht Vendimin dhe Urdhëresën e OSHP-së dhe tek raporti i Eksperti Shqyrtues ku thotë “Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar nenin 7 par.2 i LPP-së duke vendosur kritere diskriminuese në si Autoriteti Kontraktues me kërkesën e OE Lulishtja Buçaj është kërkuar Kriter që drunjtë dekorativ të jenë të Certifikuar, dhe për ne si Autoriteti Kontraktues kemi menduar që ky kriter ethe diskriminues dhe nuk është respektuar kërkesa e OE.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti z. Beqiri deklaroj: pikat e eliminimit e Autoritetit Kontraktues në lidhje me Agronom i diplomuar edhe Bachelori e plotëson këtë kriter, sa i përket referencave kontratave Autoriteti Kontraktues ka mund të kërkoj sqarim, 2 here OE i ka plotësuar kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Në kërkesën e Dudit ka qenë kërkesë të jete i noterizuar. Mbetem prapa raportit të dorëzuar 20.02.2020.

Referuesi e pyeti Ekspertin: Sa vite i ka Ing. a i ka 3 vite? Eksperti përgjigjët: Po i ka .

Referuesi e pyeti Ekspertin: Është kërkuar 370.000.00. euro a e ka plotësuar OE këtë kriter?

Eksperti përgjigjët: Po i plotëson vlerat.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Buçaj deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovon kërkesën tone si të bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Mullabazi Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues të hedhet poshtë ankesa e OE ankues si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues N.T.P “LULISHTJA BUQAJ”- Graçanicë, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 dhe 59 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta. Andaj, kjo çështje është “res judicata”. Megjithatë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se komisioni i vlerësimit të autoritetit kontraktues për të tretën herë nuk ka ri-vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar drejt ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit. Pra, AK gjatë ri vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së, ku thuhet: *“Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik”*, si dhe neni 59 par. 4 të LPP-së, ku thuhet: *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*.

Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se AK gjatë ri vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar vendimin PSH.nr.683/19 të datës 19.11.2019 dhe Urdhëresën PSH nr. 949/19 të datës 31.01.2020.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion dhe në sqarimet e ekspertit profesional të prokurimit, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së, si dhe nuk i ka marrë parasysh kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj, dilemat të cilat i ka AK, mundet që konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë. Gjithashtu, obligohet autoriteti kontraktues që ti përmbahet kërkesave të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, si dhe të vlerësoj ofertat në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Gjithashtu Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet ta ketë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Kuvendi Komunal Rahovec
- 1x1 OE – N.T.P “LULISHTJA BUQAJ”- Graçanicë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.